



REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr. 615/22

Datë: 25.07.2022

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr.06/L-054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për organizmin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, e bazuar në vendimin KGJK.nr.288/2021 të datës 18.10.2021, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i propozon Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, për miratim:

NDRYSHIMIN E PLANIT TË PUNËS SË GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATES SË
GJYKATES THEMELORE NË PRISHTINË PËR VITIN 2022

PËR:

Transferimin e gjyqtarit Rexhep Gashi nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Fiskal në Departamentin Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh krijimin e Gjykatës Komerciale dhe shuarjen e Divizionit Fiskal, si dhe duke u bazuar në nevojën për plotësim të pozitave vakante për shkak të avancimit të gjyqtarëve të Departamentit Civil në Gjykatën e Apelit, Kryetarja e Gjykatës i propozon Këshillit Gjyqësor të Kosovës të miratojë ndryshimin e Planit të Punës për vitin 2022 për Gjykatën Themelore në Prishtinë, në atë mënyrë që gjyqtari Rexhep Gashi të caktohet nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Fiskal në Departamentin Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Propozimi për ndryshim të planit të punës – transferimin e gjyqtarit në fjalë, është i bazuar në kualifikimet e tij si gjyqtar dhe se me këtë transferim do të sigurohet gjykim efikas i lëndëve.

Pjesa tjetër e planit të punës, mbetet e pandryshuar.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani – Rama





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr.616/22

KRYETARJA E GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË, Albina Shabani-Rama, në bazë të nenit 32 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr.06/L-054) dhe nenit 11 par. 3 të Rregullores Nr.02/2020, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, me datë 25.07.2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë Rexhep Gashi, **TRANSFEROHET** nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Fiskal në Departamentin Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi nga data 01.08.2022.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh krijimin e Gjykatës Komerciale dhe shuarjen e Divizionit Fiskal, si dhe duke u bazuar në nevojën për plotësim të pozitave vakante për shkak të avancimit të gjyqtarëve të Departamentit Civil në Gjykatën e Apelit, Kryetarja e Gjykatës ka vendosur që të transferoj gjyqtarin Rexhep Gashi nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Fiskal në Departamentin Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke u bazuar në kualifikimet e tij të cilat parashihen me nenin 32 të Ligjit për Gjykatat, si dhe për të siguruar një menaxhim dhe gjykim më efikas të lëndëve, sipas nenit 11 par. 3 të Rregullores Nr.02/2020 Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave.

Vendimi është mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Gjykata, Nr.02/2020 dhe nenit 11 par. 3 të Rregullores, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Nr.01/392.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

GJ.A.nr. 616/2022, Datë: 25.07.2022

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani – Rama



Vendimi u dorëzohet:

*Këshillit Gjyqësorë të Kosovës,
Gjyqtarit Rexhep Gashi,
Udhëheqësit të Departamentit Civil,
Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
Zyrës së Personelit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.*